

1 E premte, 25 gusht 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen]

4 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 14.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëdita. Mirë se vini.

8 Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem thërrisni çështjen.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar  
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i  
11 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Zyra e Prokurorit të Specializuar, kush është i pranishëm  
15 në këtë seancë sot prej jush.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita. Për ZPS-në të  
17 pranishëm janë Line Pedersen, Filippo de Minicis, Federica  
18 Genovesi dhe Gaia Pergo.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Mbrojtës i Viktimave, fjala për ju.

22 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Unë  
23 jam Simon Laws, Mbrojtësi i Viktimave.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Z. Gilissen.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
3 Gjykatës. Jemi së bashku me Pjetër Shalën që na ndjek me  
4 videolidhje. Dhe bashkë me mua është Hedi Aouini.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
6 procesverbal, z. Shala, a konfirmoni që më dëgjoni mirë?

7 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj.  
8 Faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Faleminderit.

11 Sot Trupi Gjykses do të japë disa urdhra me gojë dhe  
12 udhëzime për prezantimet e Mbrojtjes, e paraqitjes së provave  
13 nga Mbrojtja. Do të jap gjithashtu edhe tre urdhra me gojë për  
14 kërkesat që janë dorëzuar përpara Trupit Gjykses.

15 Do të fillojmë me udhëzimet që kanë të bëjnë me  
16 paraqitjen e provave nga Mbrojtja, udhëzime të cilat do të jap  
17 për një çast janë nxjerrë në pajtim me nenin 40(2) dhe (6) të  
18 Ligjit dhe rregullat 116, 119, 121, 141, 144, 145, 153 deri në  
19 154 të Rregullores.

20 Pika e parë, ka të bëjë me listën e dëshmitarëve të  
21 Mbrojtjes.

22 Trupi Gjykses ka marrë shënim, pas Konferencës për  
23 Përgatitjen e Mbrojtjes dhe përditësimeve të përmbledhjeve  
24 të dëshmimeve të pritshme të dëshmitarëve të Mbrojtjes të cilët  
25 janë marrë përmes postës elektronike dhe në orën 14.46 dhe

1 duke marrë parasysh dhe parashtrimet shtesë të ZPS-së të  
2 dorëzuara sot, parashtrimi i protokolluar 624.

3 Në fillim Trupi Gjykses vëren, se rregulla 137 e  
4 Rregullores parashikon që palët mund të dorëzojnë prova që  
5 janë me rëndësi për çështjen dhe në pajtim me rregullin 143  
6 (4) të Rregullores, marrja në pyetje e dëshmitarit dhe  
7 paraqitja e provave duhet të jetë efektive dhe duhet të  
8 shmangë konsumin e panevojshëm të kohës dhe të burimeve.

9 Për arsyet e mëposhtme, Trupi Gjykses urdhëron heqjen e  
10 dëshmitarëve të mëposhtëm nga lista e dëshmitarëve të  
11 Mbrojtjes. Këto dëshmitarë janë: 4454, dëshmitari i dytë është  
12 Dëshmitari i Mbrojtjes 4-04, dëshmitari i tretë është  
13 Dëshmitari 2517, dëshmitari i katërt është 2549 dhe dëshmitari  
14 i fundit është 4751, në pajtim me rregullën 119(3) i  
15 Rregullores.

16 Sa i takon Dëshmitar 4454, ai pritët që të japë dëshmi  
17 lidhur me dëbimin nga policia serbe e personave nga fshati i  
18 tij në mars 1999 dhe që ai u detyrua që të largohej për në  
19 Shqipëri. Ai pritët që ndër të tjera të dëshmojë lidhur me  
20 kohën e shpenzuar në Kukës me UÇK-në, në Shqipëri, në prill  
21 dhe në maj të 1999-s dhe që ka shkuar në fabrikën e përpunimit  
22 të metaleve në Kukës dy herë përpara sesa të shkonte në Burrel  
23 në fund të prillit të 1999.

24 Tani mendoj që është më mirë që të kalojmë në seancë  
25 private.

1 Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

2 [Seancë private]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
4 jemi në seancë private.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
6 Faleminderit.

7 Të nderuar Avokatë të Mbrojtjes këto janë pjesë të  
8 përmbledhjeve. A mendoni edhe ju që do ishte më mirë që këto,  
9 shtjellimi t'i bëjmë në seancë private, apo mendoni që nuk ka  
10 ndonjë problem në qoftë se këtë informacion ne mund ta ndajmë  
11 në publik? Ky është informacion, i cili me neve në fakt është  
12 ndarë apo na është dhënë në mënyrë konfidenciale, pra, në  
13 versionin konfidencial. Nuk e di sesi mendoni ju, në qoftë se  
14 doni të vazhdoni në seancë private apo të kalojmë në seancë  
15 publike?

16 Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për derisa  
17 këta janë elementë të përgjithshëm për neve nuk ka problem që  
18 të thuhet në publik. Ne nuk mendojmë që këto janë informacione  
19 identifikuese, domethënë, janë informacione të cilat mund të  
20 aplikojnë për shumë njerëz, kështu që nuk kemi problem që të  
21 vazhdohet në seancë publike.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
23 rregull.

24 Znj. Sekretare, mund të na kaloni përsëri në seancë  
25 publike, ju lutem.

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
3 jemi në seancë publike.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Faleminderit.

6 Sa i takon Dëshmitarit 4454. Ne vërejmë që ky dëshmitar  
7 ka qëndruar në shtëpinë 1 në Kukës edhe ka shkuar në fabrikën  
8 e përpunimit të metaleve në Kukës vetëm dy herë përpara fundit  
9 të prillit të vitit 1999. Si rezultat, Trupi Gjygues konstaton  
10 se dëshmia e pritshme e këtij dëshmitari është përtej kuadrit  
11 material dhe kohor të akuzave dhe nuk do ta ndihmojë Trupin  
12 Gjygues për përcaktimin e fakteve dhe për zbulimin e të  
13 vërtetës.

14 Sa i takon Dëshmitarit 4-04, i cili do të pritej që do të  
15 dëshmonte në kohën që ka kaluar në qendrën e mobilizimit në  
16 Kukës në vitin 1999, Trupi Gjygues konstaton se edhe pas  
17 parashtrime të përmbledhjeve të rishikuara, Mbrojtja nuk ka  
18 dëshmuar që dëshmitari ka qenë i pranishëm në fabrikën e  
19 përpunimit të metaleve në Kukës në kohën që lidhet me  
20 aktakuzën. Me fjalë të tjera, Mbrojtja nuk ka treguar që  
21 dëshmitari i propozuar nuk ka qenë anëtar i Brigadës 1928  
22 [sipas përkthimit] dhe se ky dëshmitar nuk e ka parë të  
23 akuzuarin në Kukës dhe kjo gjë nuk është e rëndësishme për  
24 këtë çështje.

25 Në lidhje me dëshmitarët 2517 dhe 2549, të cilët të dy

1 pritej që të dëshmonin lidhur me lirimin e të ndaluarve nga  
2 godina e MUP-it në Prizren më 18 qershor 1999. Trupi Gjykues  
3 vëren se asnjëri prej tyre nuk ka marrë pjesë në çlirimin apo  
4 lirimin e të ndaluarve, se dëshmitë e tyre janë përsëritëse,  
5 pra, përsërisin dëshminë e dhënë nga dëshmitari 03881. Dhe  
6 informacioni i përgjithshëm që do të japin ata nuk do ta  
7 ndihmojë Trupin Gjykues për vlerësimin e fakteve të veçanta të  
8 kësaj çështjeje.

9 Së fundi, lidhur me Dëshmitar 04751, deklarata e më  
10 hershme e Mbrojtjes u prezantua sipas rregullit 155 të  
11 Rregullores. Trupi Gjykues vëren se dëshmitari është  
12 stacionuar në Kukës për disa në javë në prill të vitit 1999  
13 dhe se gjatë intervistës ë tij të tij të mëparshme nuk është  
14 pyetur lidhur me të akuzuarin. Si rezultat, Trupi Gjykues  
15 konstaton se dëshmia e tij nuk përfshihet brenda afatit kohor  
16 të akuzave dhe nuk do ta ndihmojë Trupin Gjykues për  
17 përcaktimin e fakteve apo për zbulimin e të vërtetës. Përveç  
18 kësaj, Trupi Gjykues gjithashtu konstaton se dëshmia e tij  
19 është gjithashtu përsëritëse, përsërit dëshmi të cilat Trupi  
20 Gjykues më përpara i ka dëgjuar nga dëshmi të tjera.

21 Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykues vëren se  
22 Dëshmitar 04454, Dëshmitari i Mbrojtjes 4-04, Dëshmitari  
23 02517, Dëshmitari 02549 dhe Dëshmitari 04751 duhet të hiqen  
24 nga lista e dëshmitarëve të Mbrojtjes.

25 Kjo nuk përjashton faktin që Trupi Gjykues të kufizojë më

1 tej numrin e dëshmitarëve më vonë gjatë procesit gjyqësor në  
2 qoftë se konstaton se dëshmia e tyre është përsëritëse ose pa  
3 rëndësi për çështjen.

4 Ju udhëzojmë që të dorëzoni një listë të përditësuar të  
5 dëshmitarëve deri të martën më datë 29 gusht 2023. Gjithashtu  
6 ju kërkohet që të dorëzoni në dokumentacionin e çështjes deri  
7 në të njëjtën datë, përmbledhjet e rishikuara të dëshmitarëve  
8 të dërguar përmes postës elektronike dje.

9 Pika e dytë ka të bëjë me kohën që caktohet për palët  
10 edhe për mbrojtjen e dëshmitarëve për të marrë në pyetje këta  
11 dëshmitarë.

12 Mbrojtja ka thënë që i kërkohet 48.5 orë për marrjen në  
13 pyetje të dëshmitarëve të saj. Pas heqjes nga lista e  
14 dëshmitarëve të pesë dëshmitarëve për të cilët folëm më sipër,  
15 Trupi Gjyqësor konstaton se është e përshtatshme që të jepen  
16 40.5 orë për Mbrojtjen për paraqitjen e provave të veta. Kjo  
17 nuk cenon faktin që Trupi Gjyqësor të rishikojë kohën e dhënë  
18 në qoftë se dëshmitarët do të prezantohen në bazë të  
19 parashikimeve të rregullit 153 dhe 154.

20 Trupi Gjyqësor pret që Mbrojtja të respektojë kohën e  
21 përcaktuar për marrjen në pyetje të secilit prej dëshmitarëve  
22 dhe të informojë Trupin Gjyqësor në mundësinë më të parë të  
23 mundur në qoftë se parashikon më pak kohë sesa kaq. Sigurisht,  
24 në qoftë se do ju nevojitet më tepër kohë, se mund të ndodhë  
25 dhe kështu, ju lutem duhet që t'i kërkoni leje Trupit Gjyqësor

1 mjaftueshmërisht paraprakisht.

2 Njësia për Menaxhimin e Gjykatës do të informojë Trupin  
3 Gjykues, palët dhe Mbrojtësin e Viktimave, përmes postës  
4 elektronike, në fund të çdo marrje të drejtpërdrejtë në pyetje  
5 të dëshmitarit sesa kohë ka përdorur Mbrojtja dhe në fund të  
6 secilit bllok të paraqitjes së provave, sesa kohë ka përdorur  
7 Mbrojtja në tërësinë e vet për marrjen në pyetje të  
8 dëshmitarëve që ka thirrur deri në atë pikë të caktuar kohe  
9 për të dhënë dëshmi.

10 Trupi Gjykues do t'i japë ZPS-së për kundërpjetjet për  
11 secilin nga dëshmitarët e Mbrojtjes të njëjtën kohë siç është  
12 përdorur në mënyrë efektive nga Mbrojtja.

13 Ndërkohë që Mbrojtësi i Viktimave do t'i jepen 20 për  
14 qind e kohës që është përdorur në mënyrë efektive nga  
15 Mbrojtja. Kjo nuk cenon pyetje të tjera shtesë që mund të  
16 bëhen nga Mbrojtja e Viktimave për të nxjerrë prova për sa i  
17 takon qëllimeve të zhdëmtimeve.

18 Ne theksojmë udhëzimet tona në paragrafin 20 dhe 23 të  
19 vendimit për zhvillimin e procesit gjyqësor, që është  
20 parashtrimi i protokolluar 434 dhe rikujtojmë gjithashtu dhe  
21 udhëzimet e dhëna në paragrafët 44 dhe 51 të të njëjtit  
22 vendim.

23 Tani kalojmë tek pika e tretë që është urdhri për  
24 paraqitjen e Mbrojtjeve.

25 Mbrojtje, ne ju urdhërojmë që të paktën të planifikoni dy



1 dëshmitarë për bllokun e dytë të provave të dëshmime të  
2 dëshmitarëve. Me fjalë të tjera, ne ju urdhërojmë që të  
3 planifikoni të paktën një ose madje dy dëshmitarë të tjerë për  
4 atë javë. Shpresojmë që të përpiqeni ta realizoni këtë gjë. Ju  
5 lutem bëni të gjithë përpjekjet, orvatjet e nevojshme për të  
6 siguruar dëshmitë e dëshmitarëve shtesë edhe lidhuni me Zyrën  
7 Administrative për këtë arsye. Siç e përmendëm dhe dje, ju  
8 lutem merrni parasysh edhe mundësinë për të dhënë dëshmi  
9 përmes videolidhjes, pasi kjo mund të lehtësojë ardhjen në  
10 gjykatë virtualisht dëshmitarëve të tjerë shtesë.

11 Ju kërkohet që të dorëzoni një urdhër të përditësuar të  
12 dëshmitarëve për bllokun provues të gjashtë deri të premtën,  
13 më datë 1 shtator 2023. Trupi Gjykues ka marrë shënim urdhrin  
14 për paraqitjen e dëshmitarëve për bllokun e shtatë. Ndërkohë  
15 që për blloqet e tjera të dëshmitarëve juve udhëzoheni që të  
16 dorëzoni numrin dhe rendin e dëshmitarëve të paktën pesë javë  
17 më përpara.

18 Në qoftë se do ketë ndryshime të rendit të dëshmitarëve  
19 për arsye të paparashikuara, ju lutem njoftoni ZPS-në, Trupin  
20 Gjykues, Mbrojtjen e Viktimave, por gjithashtu edhe Zyrën  
21 Administrative.

22 Le të kalojmë tek pika e katërt, pra, kjo ka të bëjë me  
23 informacion shtesë që lidhet me Dëshmitarin 03.

24 Sa i takon Dëshmitar të Mbrojtjes 4-03 , Trupi Gjykues  
25 urdhëron Mbrojtjen që të dorëzojë deri nesër të premtën, data

1 8 shtator 2023, një jetëshkrim të përditësuar që mban  
2 informacion të plotë lidhur me ekspertizën dhe kualifikimet e  
3 dëshmitarit. Duke përfshirë në veçanti universitetin apo  
4 universitetet nga ky është diplomuar personi në fjalë. Sepse  
5 në raportin e marrë nuk janë dhënë hollësi. Na jepet shumë  
6 informacion, po ndërkohë është shumë e vështirë për neve për  
7 të verifikuar informacionin. Do të kërkonim që të përfshinte  
8 institucionet ku janë marrë, nga ku është trajnuar, nga ka  
9 marrë pra, trajnime shtesë dhe që ka marrë certifikatat e  
10 përmendura në faqen 2 të raportit të ekspertit t tij që është  
11 DPS00865, si dhe çdo informacion tjetër me rëndësi që shërben  
12 për të mbështetur ekspertizën e tij dhe që mund të jenë objekt  
13 verifikimi po ashtu.

14 Lidhur me Dëshmitarin e Mbrojtjes 4-06, Trupi Gjykues  
15 vëren që "Ai pritët të dëshmojë se ai nuk ka qenë në Shqipëri  
16 në periudhën nga 15 prilli 1999 deri më 26 maj 1999", kjo  
17 është citim nga përmbledhja e dëshmisë së parashikuar të  
18 dëshmitarit. Mbrojtje, Trupi Gjykues dëshiron që ju të jeni më  
19 konkret lidhur me vendin ku ka qenë ai dhe të na jepni më  
20 shumë informacion lidhur me faktin se ku ka qenë ai saktësisht  
21 gjatë kësaj periudhe kohe, përfshirë këtu dhe dokumente  
22 mbështetëse siç tregohet në përmbledhjet e përditësuar që  
23 janë dorëzuar dje pasdite pas kërkesës së Trupit Gjykues.

24 Do jetë e rëndësishme për ne për ta pasur këtë  
25 informacion paraprakisht, domethënë, përpara sesa dëshmitari

1 të thërritet që të japë dëshmi në mënyrë që palët, Mbrojtësi i  
2 Viktimave dhe Trupi Gjykues të përgatiten edhe për këtë pikë.  
3 Shpresojmë që të mund ta merrni këtë informacion nga  
4 dëshmitari dhe të na e dorëzoni këtë informacion shtesë deri  
5 të premtën, më datë 1 shtator 2023.

6 Viojrmë me pikën tjetër që ka të bëjë me dhënien e  
7 dëshmisë përmes videolidhjes - ky është udhëzimi i pestë.

8 Mbrojtja duhet të dorëzojë kërkesat për dëshmitë për t'u  
9 realizuar përmes videolidhjes të paktën pesë javë përpara sesa  
10 dëshmia e dëshmitarit, në mënyrë të tillë që të bëhen  
11 organizimet e nevojshme praktike. Kjo nuk zbatohet për  
12 dëshmitarët që janë të planifikuar për bllokun e gjashtë që  
13 është pranë. Por, në qoftë se ju vendosni që të thërrisni  
14 dëshmitarë përmes videolidhjes, udhëzoheni që të ndërlioheni  
15 me Zyrën Administrative, të koordinoni punën me ta dhe të bëni  
16 kërkesën me Trupi Gjykues sa më herët që të jetë e mundur por  
17 jo më vonë sesa të premtën, data 1 shtator 2023.

18 Sa i takon marrjes në pyetje të dëshmitarëve larg vendit  
19 të gjykimit - megjithëse e dimë që deri tani nuk është bërë  
20 asnjë parashtrim lidhur me këtë gjë - ne theksojmë udhëzimet  
21 në paragrafin 33 të vendimit për zhvillimin e procesit  
22 gjyqësor, që është parashtrimi i protokolluar 434.

23 Viojrmë më tej me udhëzimin që ka të bëjë me rregullën  
24 153 dhe 154, pra, me kërkesat mbi bazën e rregullës 153 dhe  
25 154. Ju keni thënë që synoni të dorëzoni kërkesa sipas

1 rregullës 153 dhe 154 për dëshmitarët 4405, 4441, për

2 Dëshmitarin 4440 dhe për Dëshmitarin 3881.

3 Ne ju urdhërojmë që të dorëzoni kërkesat sipas rregullës  
4 153 dhe për dëshmitarët dhe për procesverbal dua t'i theksoj  
5 edhe një herë për dëshmitarët 4405, Dëshmitarin 4441, 4280 dhe  
6 Dëshmitarin 4440 deri të hënën, 11 shtator 2023 dhe për  
7 Dëshmitarin 3881 deri të hënën datë 18 shtator 2023. Pra, në  
8 mënyrë graduale.

9 Kërkesat në bazë të rregullës 154 të Rregullores, në  
10 qoftë se Mbrojtja vendos që të dorëzojë kërkesa të tilla, i  
11 kemi parashtrimet tuaja dhe kemi parë dhe dallimin, por,  
12 megjithatë në qoftë se do vendosni të bëni kërkesa të tilla,  
13 këto kërkesa duhet të dorëzohen jo më vonë sesa 30 ditë  
14 përpara dëshmisë së dëshmitarit, kjo do t'u bëjë të mundur  
15 ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave që të t' përgjigjen kësaj  
16 kërkesë tuaj, po gjithashtu edhe Trupit Gjykues për të  
17 vendosur në kohë të përshtatshme.

18 Vazhdojmë më tej kërkesën për urdhërimin e dhënien e  
19 dëshmisë për dëshmitarët. Ne urdhërojmë Mbrojtjen që të  
20 dorëzojë kërkesat mbi bazës e rregullës 121(3) të rregullores  
21 për dëshmitarët 04405, 4441, 4280 dhe Dëshmitarin 4440 deri të  
22 hënën, 11 shtator 2023 dhe për Dëshmitarin 3881 deri të hënën,  
23 18 shtator 2023.

24 Avokat të Mbrojtjes, sa për t'ju shpjeguar paksa. Dua  
25 t'ju them që kemi vendosur që të vijojmë në paralel me

1 kërkesat mbi bazën e rregullës 153 dhe 121(3) për shkak të  
2 gjykimit efikas dhe të shpejtë. Në qoftë se kërkesat sipas  
3 rregullës 153 që keni kemi dorëzuar ju do të rrëzohen dhe në  
4 qoftë se vendosim që të dëgjojmë dëshmitarët drejtpërdrejt  
5 duhet që të jemi gati. Për këtë arsye ju kërkojmë që të merrni  
6 hapat e nevojshëm për sa i takon përgatitjes së kërkesave  
7 sipas rregullës 121, paragrafi 3.

8 Nëse më lejoni do të bëj një rishikim të shkurtër të  
9 këtij urdhri të redaktimit në Gjykatë. Vazhdojmë më tej.

10 Avokat Mbrojtës, ju kërkojmë që të përfshini në kërkesat  
11 tuaja minimalisht informacionin e mëposhtëm: Informacion  
12 konkret dhe të mjaftueshëm që identifikon dëshmitarët dhe  
13 vendin aktual të tyre të banimit; informacion që tregon që ju  
14 jeni përpjekur por nuk keni arritur që të siguronit dëshminë  
15 vullnetare të dëshmitarit dhe që është e nevojshme një urdhër  
16 i Trupit Gjykses për ta për të ardhur për të dhënë ato  
17 dëshminë e tyre këtu në Gjykatë; dhe informacionin që tregon  
18 që dëshmia e pritur ka rëndësi materiale për çështjen.

19 Në qoftë se Mbrojtja nuk e di se cili është vendi i  
20 banimit i personit në fjalë, i dëshmitarit, mund t'ia kërkojë  
21 këtë informacion ZPS-së apo mund t'ia kërkojë këtë informacion  
22 Trupit Gjykses *ex parte* sikurse e diskutuam dhe dje dhe mund  
23 t'ia kërkonit gjithashtu edhe Zyrës Administrative. Dhe ne do  
24 të sigurohemi që këtë informacion do ta marrin vesh vetëm ato  
25 palë të cilat duam që ta dinë një informacion të tillë.

1 Urdhri i tetë ka të bëjë me dorëzimin e provave jo  
2 gojore.

3 Urdhërojmë Mbrojtjen që të dorëzojë kërkesat e mundshme  
4 për pranimin e provave jogojore, nëse dëshirojnë ta bëjnë një  
5 gjë të tillë - kjo përfshin edhe materialet nga neni 37 i  
6 ligjit, gjithashtu edhe materiale të tjera - jo më vonë se të  
7 premtën, 29 shtator 2023. I kujtojmë udhëzimet tona për sa i  
8 përket dorëzimeve, kërkesat për dorëzimet e materialeve përmes  
9 dëshmitarëve dhe ju referojmë paragrafëve 55, 56 të vendimit  
10 tonë për dorëzimin e materialeve dhe pranueshmërinë e provave  
11 jo gojore.

12 Në këtë moment udhëzojmë Mbrojtjen gjithashtu që të  
13 tregojnë deri të hënë, 4 shtator 2023, cilat pjesë të  
14 materialeve ERN DPS00270 deri në DPS00863 - besoj që e dini se  
15 për çfarë bëhet fjalë - që Mbrojtja i konsideron si relevante.  
16 Sepse është dokument shumë i madh, përmban shumë informacion  
17 interesant dhe ne duam të dimë cilat janë pjesët saktësisht  
18 relevante që ju duhen.

19 Shumë mirë. Udhëzimi paraprak i joni që ishte për të  
20 gjithë që ka të bëjë me riklasifikimin e transkripteve pas  
21 plotësimit të bllokut të paraqitjes së dëshmive. Vazhdojnë me  
22 këtë pra.

23 Këtu përfundojnë udhëzimet tona për sa i përket  
24 paraqitjes së provave të Mbrojtjes.

25 Tani do të lëshojmë një urdhër me gojë në bazë të nenit

1 119(5) të Rregullores lidhur me kërkesën tuaj të Mbrojtjes për  
2 ndryshimin e listës së provave, që është parashtrimi i  
3 protokolluar 618, paragrafi 29 deri në 32.

4 Ju kërkon leje që të shtoni gjashtë materiale që kanë të  
5 bëjnë me dëshmitarët 2549, 2517 dhe 4751. Katër nga këto  
6 materiale janë deklarata të mëparshme të dëshmitarëve, ndërsa  
7 dy të tjerat janë raporte të nënshkruara apo që ndërlidhen me  
8 këta dëshmitarë.

9 Dhe ne kemi vendosur që të hedhim poshtë kërkesën e  
10 Mbrojtjes duke pasur parasysh se të tre dëshmitarët janë hequr  
11 nga lista e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe, për rrjedhojë,  
12 deklaratat e tyre të mëparshme nuk janë më të rëndësishme,  
13 s'kanë relevancë. Raportet po ashtu nuk janë relevantë për sa  
14 u përket akuzave sepse janë jashtë periudhës kuadrit kohor dhe  
15 territorial të Aktakuzës së Konfirmuar.

16 Me këtë përfundon vendimi i Trupit Gjykses.

17 Pastaj kemi vendim që ka të bëjë me kërkesën e  
18 parashtruar nga Përfaqësuesi i Viktimave më 17 korrik 2023 ku  
19 kërkon pranimin e provave jo gojore. Parashtrimi i  
20 protokolluar 593. Ky vendim lëshohet në pajtim me nenin 37 dhe  
21 40(6)(h) e ligjit dhe rregulla 138(1) e Rregullores.

22 Znj. Sekretare, a mund të na kaloni në seancë private, ju  
23 lutem.

24 [Seancë private]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Znj. Gjykatëse, jemi në

1 seancë private tani.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Tani do të trajtojmë kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave  
5 për të pranuar materialet në vijim. Së pari, një raport i  
6 përgatitur nga një oficer i Njësisë për Hetime të Krimeve të  
7 Luftës të Misionit Evropian të Sundimit të Ligjit në Kosovë,  
8 EULEX-i, që ka të bëjë me një takim me dëshmitarin 4-01.  
9 Raporti i EULEX-it dhe pika dy, dy dokumente që vijnë, burojnë  
10 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, që do t'i quajmë  
11 dokumente të ZPS-së.

12 Raportet e përgatitura nga ekspertët e imMO-s dhe Dr.  
13 Lerz për këto do të jepet një vendim veçmas.

14 ZPS-ja dhe Mbrojtja e z. Shala nuk janë përgjegjgur apo  
15 kundërshtuar këtë kërkesë.

16 Konstatojmë se raporti i EULEX-it që mban numrin ERN  
17 SITF00432531 deri në 00432531 RED, përmban materiale të  
18 mbledhura përpara krijimit të Dhomave të Specializuara,  
19 themelimit të tyre, brenda kuptimit të nenit 37 të Ligjit.  
20 Pra, duhet të vendosim për pranueshmërinë e saj në pajtim me  
21 kriteret e vendosura nga rregulla 138.

22 Lidhur me këtë Trupit Gjykues gjen që raporti i EULEX-it  
23 është relevant sepse në siguri jep, përmban prova që kanë të  
24 bëjnë me besueshmërinë e 4-01. Ka tregues të autenticitetit  
25 siç janë logoja zyrtare e EULEX-it, numri i lëndës, emri dhe



1 numri i ID të oficerit raportues të EULEX-it, vendin dhe datën  
2 e takimit me Dëshmitarin 4-01, si dhe nënshkrimet e oficerit  
3 raportues dhe oficerit aprovues.

4 Ne konstatojmë, jemi të bindur që raporti i EULEX-it  
5 është autentik, duket autentik dhe ka vlerë provuese.  
6 Gjithashtu ne jemi të bindur që nuk shkakton dëm të paduhur të  
7 akuzuarit duke pranuar këtë raport të EULEX-it, pra, duke  
8 konstatuar që Mbrojtja nuk ka ngritur kundërshtime lidhur me  
9 këtë.

10 Konstatojmë, pra, që është duhur të pranohet dhe raporti  
11 i EULEX-sit si provë.

12 Së dyti, dokumentet e ZPS-së që janë me emrin ERN 070200  
13 deri në 070201 RED dhe dokumenti 108602 deri në 138608.

14 Ne nuk e vlerësojmë të nevojshme të përdorim autoritetin  
15 tonë me qëllim të përjashtimit të njërit prej tyre për të  
16 përjashtuar. Pra, në përputhje me vendimin tonë për dorëzimin  
17 dhe pranueshmërinë e provave jo gojore, parashtrimi i  
18 protokolluar 461, nuk kemi nevojë të japim një vendim veçmas  
19 për secilin prej dokumenteve mbi pranueshmërinë e tyre dhe  
20 konsiderojmë dokumentet e ZPS-së në dispozicion të Trupit  
21 Gjykues për qëllime të marrjes së vendimit dhe aktgjykimit.

22 Ky vendim shtrihet në të gjitha dokumentet vijuese të  
23 redaktuara apo më pak të redaktuara që kanë të bëjnë me këtë  
24 si dhe përkthimet e lidhura me këtë siç parashihet nga  
25 paragrafët 42, 43 të vendimit të lartpërmendur, pra, që ishte

1   parashtrim i protokolluar 461.

2           Udhëzimet e Trupit Gjykues në paragrafin 43 për të  
3   njëjtën vendim aplikohen, zbatohen *mutatis mutantis*.

4           Trupi Gjykues urdhëron Zyrën Administrative që të caktojë  
5   një numër prove raportit të EULEX-it dhe dokumenteve të ZPS-  
6   së.

7           Me këtë përfundon vendimi gojor i Trupit Gjykues.

8           Kemi një mocion të Prokurorisë për pranimin e një prove  
9   shkresore që lidhet me të akuzuarin, shkresa e protokolluar  
10   565. Kthehemi tek vendimi i fundit.

11           Ka të bëjë me kërkesën e ZPS-së për pranimin e një prove  
12   shkresore që lidhet me të akuzuarin. Ne kemi dhënë, lëshuar  
13   këtë vendim dhe në pajtim me nenin 40(5)(h) e ligjit dhe  
14   rregullës 138 të Rregullores.

15           ZPS-ja kërkon pranimin e dy kërkesave për azil të  
16   dorëzuar nga z. Shala autoriteteve belge më 2 dhe më 9 maj  
17   2000. Ne kemi marrë një përgjigje nga Mbrojtja më 22 gusht pas  
18   dhënies së një afati kohor shtesë. ZPS-ja është përgjigjur  
19   gojarisht dje, është kundërpërgjigjur ndaj përgjigjes së  
20   Mbrojtjes së djeshme gjatë seancës së datës 24 gusht. Dhe  
21   Mbrojtja ka bërë dhe ajo vërejtje shtesë.

22           Konstatojmë parashtrimet e Mbrojtjes se mocioni i ZPS-së  
23   është dorëzuar jashtë afatit kohor. Rikujtojmë se gjatë  
24   seancës së 16 korrikut 2023 kemi urdhëruar ZPS-në që të  
25   dorëzojnë brenda datës 6 korrik, përpara përfundimit të

1 paraqitjes së provave të tyre, ndonjë, çdo kërkesë tjetër të  
2 mundshme për pranimit të materialeve sipas nenit 37 të ligjit  
3 apo materiale tjera, referenca për këtë është faqja 2017,  
4 rreshtat 18, 21 të transkriptit.

5 Për rrjedhojë, ndryshe nga pohimi i Mbrojtjes, mocioni i  
6 ZPS-së është dorëzuar brenda afatit kohor të caktuar nga  
7 Trupit Gjykses, pra, jo jashtë afatit.

8 Së dyti, për aq sa Mbrojtja argumenton se aplikimet e  
9 kërkesat për azilin janë siguruar përmes shkeljes së ligjit  
10 ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, Trupi Gjykses konstaton  
11 se kriteret e përgjithshme të drejtësisë të përshkruara në  
12 nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut  
13 zbatohen vetëm në procedura penale. Siç është pohuar në mënyrë  
14 të përsëritur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut,  
15 garancitë nga neni 6 të Konventës Evropiane zbatohen nga  
16 momenti kur një person akuzohet për një vepre penale. Dhe kjo  
17 nga momenti që "një njoftim zyrtar i është dhënë një individ  
18 nga autoritetet kompetente për një pretendim që ai ka kryer  
19 vepër penale". Duke patur parasysh se informacioni që i  
20 akuzuari i ka dhënë në kërkesat e tij në fjalë janë dhënë në  
21 kontekstin e procedurave për azil, Trupi Gjykses konstaton se  
22 neni 6 i Konventës Evropiane nuk është i zbatueshëm. Dhe, për  
23 rrjedhojë, testi i parë nën rregullën 132 të Rregullores nuk  
24 është plotësuar, pra, kriteri i parë. Pra, nuk shohim të  
25 nevojshme të vazhdojmë me tej që të marrim parasysh apo të

1 vlerësojmë dy kushtet e tjera alternative që të përcaktuara në  
2 rregullën 138(2)(a) dhe (b) të Rregullores.

3 Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses e konstaton  
4 që kërkesat për azil nuk janë të papranueshme në pajtim me  
5 nenin 132 të Rregullores dhe, për rrjedhojë, mund merren  
6 parasysh nga Trupi Gjykses në pajtim me rregullën 139(1) të  
7 Rregullores.

8 Për sa i përket argumentimit të Mbrojtjes se kërkesat për  
9 aplikim nuk mund të përdoren në procedura penale dhe se  
10 pranimi i tyre do të dëmtonte të akuzuarin, Trupi Gjykses nuk  
11 do të trajtojë këtë argument në këtë fazë. Në përputhje me  
12 qasjen e përgjithshme të Trupit Gjykses sa i përket dorëzimit  
13 dhe pranueshmërisë së provave, Trupi Gjykses shtyn marrjen e  
14 vendimit për sa i përket pranueshmërisë së kërkesave për azil  
15 në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar mbi fajësinë  
16 apo pafajësinë e të akuzuarit.

17 Në pajtim me këtë, parashtrimet e palëve lidhur me  
18 kriteret e pranueshmërisë të vendosura nga paragrafi 1, të  
19 rregullës 138 të Rregullores do të merren parasysh dhe të  
20 shqyrtohen në një fazë të më tejshme.

21 Dhe, në fund, ne urdhërojmë Zyrën Administrative që të  
22 caktojë një numër prove kërkesave për aplikim me ERN U0099245  
23 deri në U0099258. Versioni në anglisht është U0099245 deri në  
24 U0098258-ET. Pra, korrigjoj jo "Anglisht", por -ET. Dhe  
25 U0099230 deri në U0099235. Versioni në anglisht është U0099230

1 deri në U0099235-ET. Dhe për qëllimin e vetëm të mbajtjes së  
2 një shënimeve të qarta, të sakta të procesit.

3 Këtu përfundon vendimi i Trupit Gjykses.

4 Znj. Sekretare, a mund të na sillni prapë në seancë  
5 publike.

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
8 jemi tani në seancë publike.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Faleminderit.

11 Pyetje për të dy palët dhe Mbrojtësin e Viktimave. Ju  
12 është dërguar juve një email pak para se të fillonim seancën  
13 duke kërkuar disponueshmërinë tuaj për javën e parë pas  
14 pushimit të dimrit. Kemi caktuar seanca në parim për datën 15  
15 janar dhe do të donim të dinim a keni mundësi ju palët  
16 përfshirë edhe Mbrojtësin e Viktimave për atë javë pra.

17 Do t'ju ishim mirënjohës në qoftë se mund të na dërgonit  
18 datat tuaja kur keni kohë. Sa më shpejt që të jetë e mundur  
19 kjo.

20 Z. Prokuror.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Prokuroria është i disponueshëm  
22 ato ditë.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Dhe ne do jemi të pranishëm.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
25 Faleminderit.

1 Mbrojtja.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kam frikë se nuk do të jetë e  
3 mundur, por do të përpiqem, do t'i kontrolloj këto mundësi dhe  
4 do të shoh dhe do të përpiqem që ta bëj të mundur dhe t'ju  
5 informoj sa më shpejt që të jetë e mundur.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
7 të informoni deri të hënën?

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Besoj që po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot  
10 do të ishte dhe më mirë. Në qoftë se mundeni, ju falënderojmë,  
11 që na kontaktoni deri të hënën.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do ta bëj këtë gjë.

13 Z. AOUBINI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë znj. Gjykatëse. Një  
14 element shtesë lidhur me këtë për sa u përket datave.

15 Dje kemi dërguar një kërkesë ekspertit për CV-në e tij  
16 dhe dokumente të tjera. Dhe kur morëm emalin tuaj, ndoqëm  
17 udhëzimin dhe lidhur me disponueshmërinë e ekspertit për datat  
18 e ndryshme. Ndoshta nuk do marrim përgjigje nga e hënë, kështu  
19 që diçka që mund të merremi me të.

20 Por për sa i përket ekipit, të hënën natyrisht ne do t'ju  
21 japim informacione. Dhe po përpiqemi që të punojmë lidhur me  
22 këtë që të krijojmë dhe mundësinë për dëshmitarin që të jetë  
23 aty.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo  
25 që kuptoj nga ju është se po planifikoni për javën e dytë të

1 janarit që të vijë dëshmitari ekspert.

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Dhe dy ekspertë të mundshëm  
3 potencialë me të cilët po përpiqemi të konsultohemi lidhur me  
4 pikat që janë ngritur në prova nga Mbrojtësi i Viktimave. Pra,  
5 ne presim që blloku i fundit të jetë për ekspertët.

6 Nuk kemi ndonjë kontakt akoma me ekspertin e ri. Por atë  
7 që e kemi renditur në listën tonë, kemi komunikuar me të dhe  
8 po presim përgjigjen e tij për sa i përket datave kur ai  
9 mundet të vijë, pra, ato datat alternative pra. Faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
11 Faleminderit. Tani do t'i pyes edhe një herë palët në qoftë se  
12 kanë ndonjë çështje që palët dëshirojnë të ngrenë me Trupi  
13 Gjykues.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë nga ana jonë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Mbrojtësi i Viktimave.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë nga ana jonë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
19 Avokat Mbrojtës, a keni ndonjë çështje që dëshironi ta  
20 diskutoni me Trupi Gjykues?

21 Z. AOUINI: [Përkthim] Kemi një pikë të vogël znj.  
22 Gjykatëse, lidhur me kërkesat që në paralel me rregullën 153  
23 dhe 121. Në qoftë se ju përshtatet edhe juve ne do të bëjmë  
24 këto kërkesa së bashku në të njëjtët parashtime të  
25 protokolluara apo dëshiron që t'i keni veçmas? Ka një lloj

1 komunikimi mes këtyre dy rregullave, pra, mund ta formuloj në  
2 një mënyrë të tillë që në qoftë se refuzohen apo kërkohen që  
3 të paraqiten kemi një kriter që është alternativ.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është  
5 gjithmonë e rrezikshme që të kemi tema të ndryshme në një  
6 parashtrim të protokolluar, nëse arrijmë pastaj në pikën e  
7 përgjigjeve-kundërpërgjigjeve do të preferoj të kem dy  
8 parashtrime veçmas të ndara, në qoftë se s'është shumë e  
9 ndërlikuar dhe e vështirë për ju.

10 Z. AOUIINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse. Do të  
11 ndjekim këtë udhëzim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
13 ju ka të bëjë shumë kjo me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet që  
14 ndjekin rrugë të ndryshme që të mos ngatërrohen temat për të  
15 cilat diskutojmë në parashtrime. Në rregull. Faleminderit.

16 Ndonjë gjë tjetër?

17 Atëherë do të shihemi më 18 shtator me fillimin e  
18 prezantimit të provave të Mbrojtjes. Java e 18 e shtatorit  
19 data e saktë do të jepet përmes një urdhri, do të varet nga  
20 rendi sipas të cilit do të paraqisni dëshmitarët. Atëhere data  
21 e saktë do t'ju jepet në kohë.

22 Pashë që ngritët dorën z. Avokat Mbrojtës?

23 Z. AOUIINI: [Përkthim] Desha të kujtoj, e kam shënuar në  
24 transkript si njoftim, se në qoftë se do ketë dëshmitarë  
25 shtesë do të jetë ai që përmendëm dje. Ai që do përpiqemi të



1 shtojmë, 4-01. Ne po njoftojmë se kush mund të jetë dëshmitari  
2 shtesë në bllokun e gjashtë të paraqitjes së dëshmive.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A nuk  
4 është e mundur që të sillni dëshmitarë të tjerë? Sepse ideja e  
5 kërkesës time është udhëzimi jonë ishte që një apo dy  
6 dëshmitarë shtesë t'i kemi që të jem i sigurtë të përdorim  
7 gjithë javën.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Besoj  
9 që po shtuam edhe një dëshmitar tjetër rrezikojmë që të mos  
10 kemi kohë të mjaftueshme.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ta  
12 kemi si rezervë që të jemi të sigurtë që java mbushet që të  
13 mos kemi vetëm një dëshmitar, në qoftë se s'është, për  
14 shembull, nuk mund të jetë dëshmitari që ju po parashikoni,  
15 për të cilin sapo folët. Do t'ju kërkoja që të keni në mendje  
16 ndonjë dëshmitar tjetër, të përgatiteni për ndonjë tjetër. Nuk  
17 dua të ndërhyj për rendin sipas të cilit doni t'i thërrisni  
18 dëshmitarët sepse e di që ka një logjikë mënyra e paraqitjes  
19 së prezantimit të prezantimit të dëshmive të dëshmitarëve, por  
20 nuk jeni i detyruar të bëni të pamundurën, siç e thashë, po do  
21 t'ju sugjeroja që të parashikoni edhe dikë tjetër. Ky është  
22 udhëzimi që ju kam dhënë dhe që ju ka dhënë Trupi Gjykses.

23 Z. AOUINI: [Përkthim] Do të bëjmë të gjitha përpjekjet e  
24 mundshme dhe t'ju informojmë deri në datën 1 shtator.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Atëhere mbërritëm në pikën ku falënderoj palët, Mbrojtësin e  
2 Viktimave, përkthyesit dhe të gjithë të pranishmit,  
3 stenografin dhe personelin e sigurisë.

4 Seanca mbyllet.

5 Seanca mbyllet në orën 15.17

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25